



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2022:022435

Datë: 20.05.2024

Numri i dokumentit: 05707100

C.nr.78 /2022

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-DEGA NË SUHAREKË, nga Gjyqtari Robert Tunaj, me pjesëmarrjen e praktikantes Saranda Aliaj, në çështjen juridike civile të paditësit B.G me nr.personal: nga fsh G .K.K, të cilën me autorizim e përfaqëson Av.S.G nga P, ndaj të paditurës K.S,D .K e A, me objekt kontesti kompensimi për mjetet financiare të pagës në emër të diferencës për kualifikimin shkollor-gradës dhe udhëtimit, më dt.20.05.2024, bie këtë:

A K T G J Y K I M
Pa shqyrtim kryesor

- I. APROVOHET** e bazuar kërkesëpadia e paditësit B. G.
- II. DETYROHET** e paditura K e S – D. K e A, që paditësit në emër të kompensimit për mjetet financiare të pagës në emër të diferencës për kualifikimin shkollor-gradës dhe udhëtimit ,t’ia paguaj shumat si në vijim:
Paditësit B.G në emër të kompensimit të mjeteve financiare lidhur me kualifikimin shkollor, mësimdhënës me diplomë tri apo katër vjeqare 27% e pagës bazë,t’ia paguaj shumën prej **1217.7 euro** Si dhe në emër të udhëtimit gjatë ditëve te punës,në vlerë 70% dhe atë për 364 ditë pune x1.70 € (364x1.70x70%=**754.46**),me kamatë ligjore prej 8% nga data e parashtrimit të padisë me datë:04.02.2022, gjerë në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumë 125€, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësi B.G pranë kësaj Gjykate me datë 04.02.2022, përmes të autorizuarit të tij Av.S.G nga P, ka parashtruar padi kundër të paditurës K e S – D. K e A, për pagesën e kompensimit të pagës shtesë për avancim në karrierë zhvillim profesional si dhe për udhëtim sipas Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë dhe Ligji i Punës nr.03/L-212. E paditura përmes përgjigjes në padi të dt:07.03.2022 e ka kontestuar bazën e padisë dhe kërkesëpadisë për kompensimin për mjetet financiare të pagës në emër të diferencës për kualifikimin shkollor-gradës,si dhe për udhëtim dhe i ka propozuar gjykatës që e njëjta të refuzohet në tërësi si e pa bazuar. Gjykata pas vlerësimit të shkresave të lëndës, konkretisht provave materiale të bashkëngjitur padisë, e në kuptim të nenit 8 të Ligjit për procedurën kontestimore, pas çmuarjes me kujdes dhe me ndërgjegje të secilës prej tyre dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditësve, **është e bazuar.**

Në nenin 143 paragrafin 1 të Ligjit të procedurës kontestimore parashihet që: *“Me aktgjykim gjykata vendos mbi kërkesën që ka të bëjë me çështjen kryesore dhe me kërkesat aksesore.”*

Ndërsa në nenin 152 të Ligjit të procedurës kontestimore parashihet që: *“ Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi, i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seancë gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij.”*

E drejta që në këtë çështje juridiko civile vendimmarrja të bëhet pa shqyrtim kryesor, me të vetëm arsye për zbatimin e ekonomizimit të procedurës, parim ky i sanksionuar dhe i urdhëruar për gjykatën për t’u zbatuar konform nenit 10 paragrafit 1 të Ligjit të procedurës kontestimore, siç parasheh: “Gjykata ka për detyrë të përpiqet

që procedura të zhvillohet pa zvarritje dhe me sa më pak shpenzime, si dhe të bëjë të pamundur çdo shpërdorim të së drejtave procedurale që u takojnë palëve sipas këtij ligji.”

Në nenin 7 paragrafin 1 të Ligjit të procedurës kontestimore parashihet që: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.”* I autorizuari i paditësit, me rastin e ngritjes së padisë, për kompensimin pagës shtesë për avancim në karrierë dhe zhvillim profesional dhe udhëtimin, i ka bashkëngjitur padisë vërtetimet lidhur me provimin e fakteve për ditët e punës, të cilat paraqiten si bazë për kërkimin e shumave të papaguara.

Nga shikimi në vërtetimet: vërtetimi nr. protokoll i 146 i datës 11.03.2022 sh.f.m.u “Edit Durham”- Mushtisht, vërtetim nr.108 lëshuar nga SH.F.M.U “Edit Durham”-Mushtisht vërtetim nr.16/22 i datës 31.01.2022 i lëshuar nga SH.F.M.U “Sadri Duhla”- D ,diploma e Bachelorit nga Universiteti “Hasan Prishtina” nr.4261-Prishtinë, licenca e mësimdhënësit nr.1030437, kontrata e punës së mësimdhënësit me nr. protokoll i 269 i datës 08.10.2021, kontratë pune e mësimdhënësit me nr.25/20 i datës 04.02.2020 lëshuar nga Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Shkencës.

Gjykata, me rastin e aprovimit të pjesëshëm të kërkesëpadisë së paditëses dhe përcaktimit të lartësisë për kompensimin e diferencës në pagë për punonjësit me licencim-kualifikim, është bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017, e nënshkruar në mes të Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, si dhe duke u bazuar në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës me numër 01/33, të datës 29.08.2008.

Sipas dispozitës së nenit 7 paragrafi 1, pika 3 dhe pika 1.2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e datës 18.04.2017, është paraparë se: *“Me Licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi, dhe mbi bazën e kualifikimit dhe mbi bazën e kualifikimit dhe atë: Mësimdhënës me diplomë fakulteti tri dhe katërvjeçar, 27 % e pagës bazë.*

Gjithashtu, në bazë të kontratës kolektive të arsimit në Kosovë, të datës 22.01.2021, në nenin 7 për licencim thuhet se: *“Me licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi, dhe mbi bazën e licencës së fituar, bazuar në UA Nr. 5/2017 Sistemi i licencimit dhe i zhvillimit të mësimdhënësve në karrierë, u mundëson mësimdhënësve realizimin e stimulimit në të ardhurat personale, si vijon: 1.1 Mësimdhënës me Licencë të karrierës 10 % e pagës bazë. 1.2 Mësimdhënës me Licencë të avancuar 10% e pagës bazë. 1.3 Mësimdhënës me Licencë mentor 15% e pagës bazë. 1.4 Mësimdhënës me Licencë meritore 15% e pagës bazë”.*

Në vendimin e Qeverisë Nr.01/33, të datës 29.08.2008, në paragrafin 4 pika 2 dhe 3, përcaktohet se *“Mësimdhënësit me Diplomë Universitare 3 dhe 4 vite fitojnë ngritje të pagës bazë për 27%.*

Edhe në bazë të Mendimit Juridik, me nr. prot.214/2013, të datës 09.10.2023, të Gjykatës Supreme të Kosovës, është paraparë se dispozita e nenit 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 17.04.2017 dhe Kontratës në fuqi të datës 22.01.2021, ka karakter detyrues, për palët nënshkruese, në rastin konkret për të paditurën K e S.

Bazuar në provat e lartcekur, shihet se edhe kërkesa e paditësit për kompensim të shpenzimeve të udhëtimin gjen mbështetje të plotë në nenin 35 pika 5 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të dt.18.04.2017, ndërmjet SBASHKU-ut dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës, siç parashihet: *Punonjësve arsimorë(anëtarë të SBASHK-ut) që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë u paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban.*

Gjykata vendosi që t’ia falte besimin provave që ka prezentuar paditësi konkretisht vërtetimit të lëshuara nga Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Shkencës, pasi të njëjtat janë nxjerr nga një organ që është i pajisur me autorizime publike, çka për gjykatën kjo provë ka fuqi të saktësisë për atë që konfirmon, bazuar në nenin 329 paragrafit 1 të Ligjit të procedurës kontestimore.

Vendimi mbi aprovimin e kërkesëpadisë së padisë, është mbështetur në nenin 35 pika 5 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të dt.18.07.2017

Vendimin mbi shpenzimet procedurale, gjykata e mbështeti në nenin 452.1 të LPK-së duke ia njohur paditësit shpenzimet e procedurës sipas udhëzimit administrativ nr.01/2017, detyrohet e paditura që të paguaj të gjitha shpenzimet procedurale gjyqësore sipas TOA dhe atë në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Gjykata aktgjykimin e ka marr në kuptim të nenit 152 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-DEGA NË SUHAREKË,
C.nr.78/22 dt.20.05.2024**

Gjyqtari
Robert Tunaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditëve pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.